



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA E PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 277/1 Prot.

Patos më, 26/09/2025

VENDIM

Nr. 59, datë 22.09.2025

**MBI MIRATIMIN E PROJEKT DOKUMENTIT TË RISHIKUAR FAZA E DYTË,
TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2026-2028.**

Në zbatim të shkronjës “dh” të nenit nr. 54, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, nenit 4, 6, 15, dhe 17, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 68, datë 27.04.2017, për “Financat e vetëqeverisjes vendore”, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, udhëzimit nr. 23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”, udhëzimit nr. 08 datë 28.02.2025 i Ministrisë së Financave “Për përgatitjen e buxhetit afatmesëm vendor 2026-2028”, VKB nr. 10, datë 26.02.2025 “Për vlerësimin, parashkrimin afatmesëm të të ardhurave të bashkisë Patos për vitet 2026-2028”, VKB nr. 14, datë 19.03.2025 “Për miratimin e tavanëve përgatitor të PBA 2026-2028”, VKB nr. 31, datë 30.06.2025 “Mbi miratimin e projekt dokumentit të programit buxhetor afatmesëm vendor 2026-2028 faza e parë”, VKB nr. 40, datë 18.07.2025 “Mbi miratimin e tavanëve përfundimtar të pba 2026-2028, Udhëzimi Plotësues nr. 19, datë 10.07.2025 i Ministrisë së Financave “Për përgatitjen e Programit buxhetor afatmesëm vendor 2026-2028”, Këshilli i Bashkisë i mbledhur më datë 22.09.2025 pasi analizoi projektvendimin e paraqitur nga Grupi Menaxhimit Strategjik

VENDOSI:

1. Të miratohet projekt dokumenti i Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 faza e dytë, i rishikuar.
2. Bashkëlidhur vendimit gjeni projekt dokumentin e PBA-së për periudhën 2026-2028 faza e dytë, i rishikuar dhe tabelat të përgatitura sipas sistemit të menaxhimit buxhetor (smbv.fvv.al) dhe shtojcave të udhëzimit nr. 08, datë 28.02.2025 .
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet ekzekutivi.
4. Ky vendim u shpall në datën 26.09/2025.
5. Vendimi hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.



KRYETARI

Armand Ahmetaj